

# Dokument diskutimi për Dialogun Konsultativ të Mediave

---

## Mbi të vërtetat e pakëndshme dhe besimet e pabazuara

### Informata të përgjithshme

Për dekada me radhë, marrëdhëniet midis Serbisë dhe Kosovës janë shoqëruar, mes faktorëve të ndryshëm, me manipulime politike, një të kaluar të pazgjidhur, dhe gjuhë konfliktuoze. Në të dyja rastet, këmbëngulja e narrativave nacionaliste, shpeshherë e bazuar në nocione të viktimizimit, nënkupton që njihen vetëm vuajtjet e 'njerëzve të tyre'. Dhembshuria për 'tjetrit' mungon. Ky Dialog Konsultativ të Mediave ka sjellë në një vend përfaqësuesit profesionistë të medias dhe shoqërinë civile për të diskutuar mbi faktorët që mbështesin këtë fenomen, duke eksploruar mënyra të mundshme për tejkalimin e disa prej mangësive të vërejtura në mbulimin e të vërtetave të pakëndshme.

Në këtë DKM u shtjelluan disa nga pyetjet vijuese:

1. Pse është kaq e vështirë të shihet vuajtja e 'tjetrit'?
2. Çfarë mund të bëjnë mediat dhe shoqëria civile për ta lehtësuar pajtimin me të kaluarën, përfshirë raportimin mbi të vërtetat e pakëndshme?
3. Si mund ta ndryshojë media (mbase edhe shoqëria civile) gjendjen aktuale?

*Të gjithë pjesëmarrësit morën pjesë në cilësi personale dhe aktivitetet u zhvilluan sipas rregullit Chatham House.*

### Pikat e diskutimit

Pjesëmarrësit u dakorduan se gjatë njëzet viteve të fundit, apo më shumë, mediat në Serbi dhe Kosovë kanë shfaqur mungesë të ndjeshmërisë ndaj dhimbjes së tjetrit.

Kryesisht, ata i përmbahen narrativave të tyre, me nëntone përgjithësisht nacionaliste. Atëherë kur përmenden viktimat, flitet vetëm për viktimat e tyre. Madje, një pjesëmarrës i përshkroi mediat si 'kampionet e mostolerancës', ndërsa ato që ishin në shënjestër të mediave pro-qeveritare pozicionoheshin sipas politikës mbizotëruese.

1. Të gjithë pjesëmarrësit ranë dakord se raportimi i mediave në Kosovë dhe Serbi mbi 'vuajtjen e tjetrit' nuk është as i saktë dhe as i duhur. Në të vërtetë, raportimi shpeshherë shërben për të thelluar mostolerancën.
2. Mediat *mainstream* dhe transmetuesit publikë janë nën ndikimin e qeverive të tyre përkatëse, gjë që ndikon drejtpërdrejtë në saktësinë dhe profesionalizmin e raportimit të tyre. Shumica dërrmuese e pjesëmarrësve theksuan se problemet kryesore janë kontrolli politik ose i pronarëve mbi mediat, censura dhe, më e rëndësishmja, vetëcensura.
3. Sipas pjesëmarrësve të ndryshëm, manipulimi politik ka të bëjë me numrat e të vdekurve ose të zhdukurve, dhe (në Kosovë) viktimat e dhunës seksuale.
4. Në përgjithësi, pjesëmarrësit konkluduan se mediat do të stigmatizoheshin nëse do të fillonin të raportonin për dhimbjen dhe vuajtjen e (të ashtuquajturit) 'tjetrit'. Një shembull i përmendur ishte largimi nga puna i këshilltarit të Albin Kurtit, Shkëlzen Gashi, për deklaratat se kishte individë të armatosur nga radhët e shqiptarëve të Kosovës që kanë kryer krime kundër komuniteteve të tjera.
5. Kishte dallime të thella në mendimet mbi shkallën në të cilën Serbia dhe Kosova janë përballur me të kaluarën. Një pjesëmarrës pohoi se Serbia ishte përballur me këto çështje me dorëzim të anëtarëve të udhëheqjes së saj politike dhe ushtarake në Hagë, duke pohuar se Kosova vetëm tani po i hynte këtij procesi si pasojë e Dhomave të Specializuara. Kjo u kundërshtua nga pjesëmarrës të ndryshëm, të cilët theksuan vazhdimësinë e aspekteve të udhëheqjes politike të Serbisë nga vitet e nëntëdhjeta dhe mungesën e pajtimit në nivel shoqëror.
6. Në Kosovë, raportimi për Dhomat e Specializuara ka tendencë të animimit. Nuk ka fokus të mjaftueshëm në akuzat e përfshira në aktakuzat, në veçanti për krimet që pretendohet të jenë kryer ndaj shqiptarëve të tjerë të Kosovës ose anëtarëve të komuniteteve joshumicë. Në vend të kësaj, raportimi është përqendruar vetëm në krimet e kryera kundër shqiptarëve të Kosovës. Një

pjesëmarrës pohoi se çështja e dhimbjes dhe vuajtjes së komunitetit shqiptar të Kosovës është përdorur për nevoja ad hok.

7. Disa pjesëmarrës ranë dakord se bashkësia ndërkombëtare ka vendosur standarde të caktuara dhe ato vazhdojnë të respektohen përgjithësisht, kur bëhet fjalë për gjuhën e përdorur ndaj komuniteteve të tjera në Kosovë. Për shembull, ka ndalime të përdorimit të termave pezhorativ ndaj pakicave. Ky qëndrim u kontestua nga disa pjesëmarrës të tjerë.
8. Në Serbi, përdorimi i shprehjeve nënçmuese dhe dehumanizuese për shqiptarët e Kosovës është bërë normë në mediat tabloide dhe homologët e tyre elektronikë. Ndërkohë, serbët shpesh portretizohen si 'armiku i përjetshëm' nga mediat kosovare në shqip.
9. Mediat sociale janë identifikuar si fushëbetejakryesore që nxit polarizimet. Megjithatë, pika kryesore të diskutimit ishin mediat tradicionale të cilat është menduar se zbatojnë politika të duhura editoriale.
10. Agjendat e mediave janë të stërngarkuara me ngjarje politike dhe tituj sensacional. Hapësira për të shfaqur vuajtjen e 'tjetrit' dhe për të përfaqësuar anën njerëzore të të dy shoqërive është jashtëzakonisht e kufizuar. Një pjesëmarrës u ankua se hiperprodhimi i përmbajtjes politike nuk lë hapësirë të mjaftueshme për storie njerëzore, problem ky i shtuar nga tendencat që dialogu Beograd-Prishtinë të monopolizojë diskutimet mbi marrëdhëniet Kosovë-Serbi.
11. Në mediat serbe, incidentet kundër serbëve në Kosovë gjejnë hapësirën e duhur, por krimet nga autoritetet serbe kundër shqiptarëve të Kosovës janë shpërfillur. Në mediat kosovare, raportimi sugjeron se nuk ka pasur incidente me bazë etnike në dhjetë vitet e fundit, por vetëm probleme që vijnë nga krimi i organizuar, veçanërisht në veri të Kosovës.
12. Njerëzit në pjesët e Serbisë që nuk janë afër Kosovës (p.sh. Shabaci, në perëndim) janë kryesisht të painteresuar për çështjen e Kosovës.
13. Raportimi negativ mbi komunitetin serb në Kosovë ndonjëherë paraqitet me lidhje me Rusinë. Një kishë në Pejë ishte akuzuar për 'shërimin e Covid përmes ziles së kabanave', të cilën një 'ekspert' e përshkroi si 'praktikë tradicionale

ruse'. Në realitet, kisha kishte njoftuar më parë se kambanat e saj do të bien çdo orë gjatë pandemisë.

14. Mungesa e bashkëpunimit midis gazetarëve serbë dhe kosovarë u identifikua si problem i madh. Nuk ka bashkëpunim mes Asociacioneve të Gazetarëve ndërsa pak media bashkëpunojnë.
15. Mediat (veçanërisht transmetuesit publikë) në përgjithësi nuk angazhohen për edukimin e audiencës së tyre, edhe pse ky është një nga tre parimet themelore mbi të cilat bazohet transmetimi publik (informimi, edukimi dhe argëtimi).
16. Përfaqësuesit e mediave serbe gjithashtu identifikuan arsyet e mëposhtme specifike për mungesën e ndjeshmërisë ndaj tjetrit:
  - a) Efektet e tabloideve (përfshirë shumicën e stacioneve televizive me frekuencë kombëtare por me politika editoriale të tabloideve);
  - b) Kërcënimet dhe presioni nga pjesët radikale të shoqërisë;
  - c) Trysnia në Media Sociale;
  - d) Mungesa e vullnetit politik për të njohur vuajtjet e "tjetrit";
  - e) Politizimi i përgjithshëm i jetës së përditshme.
17. Përfaqësuesit e mediave kosovare si probleme kryesore i shohin si në vijim:
  - a) Stigmatizimi i atyre që shkruajnë për vuajtjet e tjetrit;
  - b) Vetëcensura ose kontrolli nga pronarët ose autoritetet;
  - c) Diskurs publik nga politikanët që i ngjan viteve të 1990-ta;
  - d) Retorika populiste dhe hakmarrëse nga politikanët e kryer nga media pa verifikim të fakteve ose kontekstualizim;
  - e) Mungesa e vullnetit politik për të njohur vuajtjet e "tjetrit";
  - f) Prania në jetën publike e 'brezit të luftës', dhe, përsëri, mungesa e vullnetit politik.
18. Shoqëria civile u vlerësua si pararendës në përballje me të kaluarën dhe trajtimin e çështjeve të drejtësisë tranzicionale, të dyja këto të neglizhuara tej mase nga mediat dhe udhëheqësit politikë. Këta të fundit përqendrohen vetëm në dhimbjen e pësuar nga vendi i tyre dhe nuk kanë vullnet për t'i përballë çështjet së bashku.

## Mbi Dialogun Konsultativ të Mediave

Dialogu Konsultativ të Mediave zhvillohet në kuadër të projektit *Përforcimi i zërave lokalë për zhvillim të barabartë, (ALVED)*, i cili financohet nga Fondi i Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për Konflikt, Stabilitet dhe Siguri (CSSF). Dialogu bashkon profesionistë dhe ekspertë nga sektorë të ndryshëm të mediave në Kosovë dhe Serbi për të kontribuar në të kuptuar më të thellë të mjedisit mediatik dhe mënyrave dhe mjeteve të mundshme për t'u përballë me narrativet përçarëse dhe për t'i sfiduar ato.